

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Dekore per festat”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
(Dekorime) 45451000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,916,580 (dy milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lek pa TVSH

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlllogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçë**ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2019, 2020, 2021**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e vlerës se parashikuar te kontrates.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 paragrafi 2 pika b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në : nenin 43 pika 1 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Përtatimin mbtë ardhurat", I ndryshuar, Udhëzimet të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Përtatimin mbtë ardhurat", I ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarata vetatimore dhe të dokumenteve të tjeratimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e references, sasite, specifikimet teknike jane hartuar nga personat pergjegjes per hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr. 1448 Prot., date 11.11.2022.

Specifikimi i materialeve:

Objekti i procedures: “Dekore per festat”

Nr	Emertimi I materialeve	Njesia	Sasia
1	Elemente dekorative te ndricuar ne forme harku	cope	150
2	Furnizim vendosje ndricues tubolar fotosuline LED ne gjithe Kinemane	m	1200
3	Instalacion metalik ne formen e numrit 3 i ndertuar me profile hekuri	cope	1
4	Instalacion metalik ne forme rrethi	cope	11
5	Instalacion metalik ne forme ylli	cope	1
6	Instalacion metalik ne forme piramidash trekendore	cope	1
7	Kavo ø6mm	m	700
8	Morseta per kavo ø6mm	cope	150
9	Kapese plastike shternguese ngjyre te zeze 300x3,6mm	pako	410
10	Izolant elektrik	cope	20
11	Kabell elektrik 3 x 2.5	m	300
12	Tenditore kavo ø12	cope	30
13	Vida filetante 60x6mm	cope	1000
14	Vida filetante veteshpuese 30x4mm	cope	1000
15	Bulona metalike plus dado 80x8mm	cope	200

Specifikime teknike


1.Elemente dekorative te ndricuar ne forme harku.

I krijuar me profile hekuri 20X20x1.5 te kalandruar dhe te lyer me boje vaji.

Me lartesi 340 cm, gjeresi 20 cm, sipas projektit + ndricues tubolar Fotosuline LED, ne gjithe perimetrin e struktures, ngjyra e bardhe e ngrohte 4000K me mufta hermetike per secilin element.

I kapur me strukturen metalike me fasheta plastike cdo 20cm, 2 elemente per cdo peme, gjithsej 70 peme, ne total 140 elemente.

Fasheta kapse metalike ne forme qafore per elementet dekorative te pemeve me diameter 30cm-100cm. Lidhja elektrike me kabel 3x2.5mm per te gjithë elementet te vendosur ne pemet e bulevard Republika ne gjithë gjatesine e tij.



2.Furnizim vendosje 1200 m ndricues tubolar fotosuline LED ne gjithë perimetrin e struktures se Kinemase.

Ngjyra e bardhe e ngrohëte 4000 K me mufta hermetike.

Vendosja do te kryhet ne gjithë siperfaqen ballore te godines duke konturuar te gjithë perimetrin e dritareve dhe relievit te godines duke fiksuar fotosulinen me kapese plastike me gozhde $\varnothing 14$.

Fotosulines duhet ti jepet energji me kabell elektrik 3 x 2.5 mm

3.Instalacion metalik ne formen e numrit 3.

I ndertuar me profile hekuri 20 x 20 x1.5 te kalandruar dhe te lyer me antiruxho dhe boje vaji ngjyre te zeze.

Me lartesi 400 cm,gjeresi 300 cm dhe thellesi 100 cm.

Struktura duhet te jete e veshur ne te gjithë perimetrin me fotosuline led 6400 kelvin,36 led/meter, me mundesi bashkimi dhe mufta hermetike.

Nderkohe qe ne brendesi struktura duhet te mbushet me shirite ndricues me drita led cdo 5 cm,standarti IP44,12 Volt, me ngjyre te bardhe 6400 kelvin, me mundesi bashkimi me mufta hermetike.

4.Instalacion metalik ne forme rrethi

I ndertuar me profile hekuri 20X20x1.5 te kalandruar dhe te lyer me antiruxho dhe boje vaji ngjyre te zeze.

Me diameter te jashtem 150cm dhe diameter te brendeshem 60cm, te lidhur me njeri tjetrin me te njejtin profil, ne forme rezesh, sipas pershkrimit nepermjet fotos.

E veshur ne te gjithë elementet me fotosuline led me ngjyre te kuqe, 36 led/meter, me mundesi bashkimi dhe mufta hermetike.

Cdo element duhet te furnizohet me dy mbajtese metalike per te siguruar vendosjen e tyre ne shtyllat pergjate pedonales se qytetit.



.Instalacion metalik ne forme ylli

I ndertuar me profile hekuri 20 x 20 x1.5, te lyer me antiruxho dhe boje vaji ngjyre te zeze.

Me dimensione 500 x 400 x 50 cm, struktura duhet te jete e veshur ne te gjithe perimetrin me fotosuline led 6400 kelvin, 36 led/meter, me mundesi bashkimi dhe mufta hermetike.

Nderkohe qe ne brendesi struktura duhet te mbushet me shirite ndricues me drita led cdo 5 cm, standarti IP44, 12 Volt, me ngjyre te bardhe 6400 kelvin, me mundesi bashkimi me mufta hermetike.

6.Instalacion metalik ne forme piramidash trekendore

I perbere nga dy elemente, ndertuar me profile hekuri 20X20x1.5, te lyer me antiruxho dhe boje vaji ngjyre te zeze.

Me dimensione: - elementi i pare lartesi 400 dhe baze 200 x 200 x 200cm,

-elementi i dyte lartesi 200 dhe baze 100 x 100 cm

Struktura duhet te jete e veshur ne te gjithe perimetrin me fotosuline led 6400 kelvin, 36 led/meter, me mundesi bashkimi dhe mufta hermetike.

Nderkohe qe ne brendesi struktura duhet te mbushet me shirite ndricues me drita led cdo 5 cm, standarti IP44, 12 Volt, me ngjyre te bardhe 6400 kelvin, me mundesi bashkimi me mufta hermetike.

Furnizimi do te kryhet brenda 10 diteve nga data e lidhjes së kontratës prane Autoritetit kontraktor me shpenzimet e furnizuesit deri ne magazinën e Ndermarrjes se Sherbimeve Publike .

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi :**Kjo kontrate ka per qellim realizimin e furnizimit me dekoret e nevojshme per festat e fundvitit.**

Afati:10 (dhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36,162/2020 te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Automjetet jane kerkuar sipas sasive dhe nevojane efektive per te permbushur nevojat e ndermarrjes ne menyre te plote per realizimin e sherbimeve ne interes te komunitetit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.